

Universiteti i Prishtinës
“Hasan Prishtina”

UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

Fakulteti i Mjekësisë

Bulevardi i Dëshmorëve p.n, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381-38-512221 URL: <http://www.uni-pr.edu>

Fax: +381-38-512223 Mail: fakultetimjekesise@gmail.com

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I MJEKËSISË
PRISHTINË

Pranuar me: 28.07.2015			
Nj. org.	Numër	Shtoiça	Vlera
	6048		

Ref. nr.

Prishtinë, 27/07/2015

RAPORT I KOMISIONIT TË ANKESAVE TË FAKULTETIT TË MJEKËSISË PËR PROVIMIN PRANUES - AFATI I
PARË, 2015

Komisioni për shqyrtim të ankesave i emëruar nga Këshilli i Fakultetit të Mjekësisë me vendimin nr. 5439, të datës 10.07.2015, shqyrtoi të gjitha ankesat e kandidatëve që iu nënshtruan provimit pranues në Fakultet të Mjekësisë. Komisioni për ankesa paraprakisht konsultoi Komisionin për pranim të studentëve në lidhje me saktësinë e testeve dhe ecurinë e vlerësimit të testeve.

Në afatin e paraparë për ankesa, janë paraqitur gjithsejt 274, dhe sipas drejtimeve është kjo pasqyrë:

Drejtimi	Kandidatët prezent	Kandidatët që munguan	Gjithsejt
Mjekësi e përgjithshme	115	35	150
Stomatologji	52	10	62
Farmacii	30	27	3
Infermieri	8	7	15
Fizioperapi	9	2	11
Mami	3	3	6

Gjatë shqyrtimit të të gjitha ankesave të kandidatëve, si dhe atyre që kishin dyshime rreth formulimit të pyetjeve, të cilët patën mundësi të konsultohen me profesorët e lëndëve përkatëse (përpilues të testit), e që ishin **13 – për lëndën e Kimisë dhe 21 - për lëndën e Biologjisë**, rezultoi se asnjëri nuk kishte të drejtë në ankesat e parashtruara.

Kandidatja **Aida Golemi me nr. të testit 100025**, e cila ka aplikuar në drejtimin – Mjekësi e Përgjithshme, është shtetase shqiptare nga Shqipëria (pra tërë shkollimin e ka kryer në Shqipëri), por për test gabimisht është listuar në listën nga Kosova dhe pas publikimit të rezultateve kjo ishte me numrin rendor **502**, gjë që nuk hyn në listën e të pranuarve. Pas shqyrtimit të ankesës dhe të gjitha fakteve, u vërtetua se kandidatja ka kaluar pragun e kalueshmërisë (pikët e testit – 35.9, ndërsa pikët totale - 51.9) dhe u vërtetua se gabimisht është listuar në grupin e kosovarëve, prandaj Komisioni erdhi në përfundim se kandidatja duhet të bartet në listën e kandidatëve nga Shqipëria dhe pasi që plotëson kriteret e konkursit për shtetas të huaj, me automatizëm **konsiderohet e pranuar**.


Në bazë të informatave që posedon Dekanati i FM për kandidatin **Donard (Gazmend) Bajrami**, i ranguar në drejtimin Stomatologji, ka dyshime për falsifikim të pikëve të paraqitura në diplomën e SHMM " Dr ALI Sokoli", në Prishtinë dhe për këtë arsye është rishikuar dosja e tij. Kandidati i cekur me lartë në vitin shkollor 2014/2015 , ka aplikuar në Drejtimin Stomatologji dhe **ka prezentuar diplomën me numër të pikëve – 41.75**, dhe nuk është pranuar. Kandidati ka aplikuar për herë të dytë në vitin shkollor 2015/2016 dhe ka **prezentuar diplomën me numër të pikëve 56.75**, dhe këtë herë është rradhitur në grupin e të ranguarve, me nr. 35. Këto rrethana zgjuan dyshimin dhe Komisioni për ankesa i FM, mori vendim që ky kandidat të **pezullohet nga lista e të ranguarve për pranim** deri në momentin e verifikimit të fakteve nga strukturat relevante.

Komisioni për shqyrtimin e ankesave

1. Prof. ass. dr Shemsedin Sadiku, kryetar

2. Prof. asoc. dr Hasime Qorraj – Bytyqi, anëtare

3. Ass. Miranda Stavileci, anëtare



Prishtinë, 27.07.2015